



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Nr. 987 prot.,

Tiranë, më 26.03.2026

Plani Vjetor I Punës Per Vitin 2026 **Sektori i Zbatimit të Rregullores së Monitorimit dhe Transparencës (REMIT)**

Në zbatim të detyrave funksionale të Sektorit REMIT, në kuadër të Rregullores së Monitorimit dhe Transparencës së Tregut të Energjisë me Shumicë (REMIT), nga ana e Sektorit është përgatitur programi vjetor i aktiviteteve për vitin 2026, si vijon:

- Përditësimi dhe mbikëqyrja e të dhënave që subjektet plotësojnë për regjistrimin në REMIT te platformat e dedikuara për këtë regjistër, si dhe mbajtja e korrespondencave përkatëse nëpërmjet shkresave apo email-it të dedikuar për këtë platformë, në rast nevojë ose mosplotësimi të dokumentacionit.
- Monitorimi i vazhdueshëm i aktivitetit tregtar të produkteve të energjisë me shumicë, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e tregtisë bazuar në informacion të brendshëm dhe manipulimin e tregut vendor.
- Në rast nevojë, bashkëpunimi dhe koordinimi me rregullatorët e energjisë të palëve kontraktuese në kuadër të Komunitetit të Energjisë, me Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritete të tjera kompetente, për hetim dhe zbatim efektiv të Rregullores REMIT.
- Ndjekja e seancave dëgjimore që mund të organizohen/planifikohen gjatë vitit për çështje që i ngarkohen Sektorit të Zbatimit të Rregullores së Monitorimit dhe Transparencës (REMIT) për ndjekje.
- Përgatitja e informacioneve për Bordin mbi analizën e punëve për tremujorin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të vitit **2026** nga Sektori REMIT, në zbatim të Rregullores së Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.
- Ndjekja e workshop-eve, aktiviteteve apo trajnimeve, sipas rastit, përgjatë vitit 2026, brenda apo jashtë vendit, si dhe online.

- Në rast nevojë, fillimi i hetimeve të nevojshme për shkelje të dyshuara, ndërmarrja e veprimeve korigjuese përkatëse, koordinimi i hetimeve me efekt ndërkufitar dhe adresimi i çdo kërkesë për informacion të ardhur nga Bordi Rregullator, duke marrë pjesë aktive në grupet hetimore të koordinuara prej tij.

Punoi : Xh. Kreku

Koordinator

Sektori i Zbatimit të Rregullores së Monitorimit dhe Transparencës (REMIT)

Miratoi: E .B .Radheshi

Sekretar i Përgjithshëm